



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. 1259 / Prot.

Tiranë, më 24.04. 2025

Lënda: Dërgojmë Vendim nr.223, datë 17.04.2025 të Këshillit të Ministrave.

Drejtuar: Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm
Departamentit të Policisë Kriminale
Departamentit për Sigurinë Publike
Departamentit për Kufirin dhe Migracionin
Departamentit për Marrëdhëniet ndërkombëtare
Departamentit për Shërbimet Mbështetëse
Departamentit për Teknologjinë e Informacionit
Akademi të Sigurisë
Drejtorisë së Antiterrorit
Institutit të Policisë Shkencore
Drejtorisë së Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Standardeve Profesionale
Drejtorisë për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median
Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave
Drejtorisë së Integritetit dhe Planifikimit Strategjik
Drejtorisë së Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor
Sektorit të Shërbimeve Ekonomike për Aparatin
Sektorit të Financës për Aparatin
Sektorit të Auditimit

K ë t u

Drejtorisë Vendore të Policisë

Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit

Bashkëlidhur ju dërgojmë **Vendimin nr. 223, datë 17.04.2025 të Këshillit të Ministrave.** “ Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për kohën e punës, pushimit dhe trajtimit financiar të punonjësit të policisë, kur nuk kryen pushimet, lejet pa të drejtë page dhe kushtet e posaçme të punës për punonjëset shtatzëna të Policisë së Shtetit”.

Nga ana juaj të merren masa për njohje dhe zbatim.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen.

ZËVENDËSDREJTORI I PËRGJITHSHËM

Drejtues i Lartë Sokol BIZHGA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHTETIT
Nr. 3345 Prot.
Datë, më 22.4.2025

V E N D I M

Nr. 223, datë 17.4.2025

P Ë R

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE
PËR KOHËN E PUNËS, PUSHIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR
TË PUNONJËSIT TË POLICISË, KUR NUK KRYEN PUSHIMET,
LEJET PA TË DREJTË PAGE DHE KUSHTET E POSAÇME
TË PUNËS PËR PUNONJËSET SHTATZËNA TË POLICISË
SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 76 deri në 108, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 100, pika 7, 101, pika 5, e 102, pika 4, të ligjit nr.82/2024, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

KREU I
KOHËZGJATJA E PUNËS/SHËRBIMIT

Neni 1
Koha e punës

1. Koha normale e punës/shërbimit për punonjësit e Policisë së Shtetit është 40 (dyzet) orë në javë. Për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji llogaritet, mesatarisht, me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune.

2. Punonjësit të policisë i sigurohet një pushim ditor i pandërprerë, prej 11 (njëmbëdhjetë) orësh, para marrjes së shërbimit/punës.
3. Shërbimet e policisë, si rregull, organizohen sipas një planifikimi 24-(njëzet e katër) orësh, me turne, nga 8 (tetë) orë secili.
4. Kohëzgjatja e punës natën nuk mund të jetë më shumë se 8 (tetë) orë pa ndërprerje. Ajo duhet të paraprihet ose të pasohet me pushim ditor të menjëhershëm.

Neni 2

Shtesa mbi pagë për shërbim jashtë orarit

1. Punonjësi i policisë që shërben natën, në ditët e pushimit javor e të festave zyrtare, brenda kohëzgjatjes normale ditore të punës, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:
 - a) 20% për çdo orë pune e shërbimi të kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00;
 - b) 50% për çdo orë pune e shërbimi të kryer nga ora 22:00 deri në orën 6:00;
 - c) 25% për çdo orë pune të kryer në ditët e festave zyrtare dhe ditët e pushimit javor.
2. Shtesa mbi pagë, sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet bashkë me pagën mujore, brenda një muaji nga dita kur është kryer shërbimi.

Neni 3

Zgjatja e kohës së punës/shërbimit

1. Për nevoja pune/shërbimi, me urdhër të titullarit të njësisë shpenzuese, punonjësit të policisë mund t'i ndërpritet koha e pushimit ditor/javor, duke urdhëruar zgjatjen e kohës së punës/shërbimit.
2. Zgjatja e kohës së punës/shërbimit urdhërohet nga titullari i njësisë shpenzuese pas kërkesës së eprorit të drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë. Në rrethana të jashtëzakonshme, eprori i drejtpërdrejtë mund të urdhërojë zgjatjen e kohës së punës/shërbimit, por ai duhet të njoftojë titullarin e strukturës përkatëse brenda 2-4 orësh.
3. Urdhri për kohën shtesë të punës/shërbimit mbi kohën normale duhet të përcaktojë:
 - a) arsyen e zgjatjes së orëve të punës/shërbimit;
 - b) kohën e fillimit dhe të përfundimit;

- c) numrin e punonjësve;
 - ç) koston financiare.
4. Orët shtesë të punës/shërbimit kompensohen me pushim të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00 - 6:00. Kompensimi me pushim i orëve shtesë të punës dhe i shërbimit bëhet brenda 2 (dy) muajve nga dita kur janë kryer ato.
 5. Në rast të pamundësisë së kompensimit të orëve shtesë të punës/shërbimit me pushim, punonjësi i policisë kompensohet me shtesë page në masën e përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.

Neni 4 -

Zgjatja e kohës normale të punës/shërbimit gjatë sezonit turistik veror

1. Aktivizimi i punonjësve të policisë në punë/shërbim me zgjatje të kohës normale të punës/shërbimit, 4 (katër) orë për çdo turn/shërbim, bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe realizohet gjatë sezonit turistik veror, për periudhën nga data 16 qershor deri në datën 15 shtator.
2. Zgjatja e kohës normale të punës/shërbimit, 4 (katër) orë për çdo turn/shërbim, gjatë sezonit turistik veror, për periudhën nga data 16 qershor deri në datën 15 shtator, kompensohet me pagë dhe pagesa kryhet bashkë me pagën mujore të muajit kur është kryer shërbimi.

KREU II

PUSHIMET VJETORE

Neni 5

Pushimet vjetore të paguara për punonjësit e policisë

1. Punonjësi i policisë gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara, si më poshtë:
 - a) 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e policisë me gradën “drejtues” deri “drejtues madhor”;
 - b) 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e policisë me gradën “nënkomisar”, “komisar” dhe “kryekomisar”;
 - c) 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për punonjësit e policisë me gradën “inspektor”.

2. Të gjithë eprorët kanë për detyrë që të sigurojnë kushtet për kryerjen e pushimeve vjetore të punonjësve që kanë në varësi.
3. Planifikimi dhe koha e kryerjes së pushimeve vjetore miratohet nga titullari i strukturës përkatëse, pas konsultimit me punonjësin, pa cenuar vijueshmërinë e punës, deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës.
4. Punonjësi ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor edhe në periudha të ndryshme e të ndara, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, me miratimin e titullarit përgjatë vitit të punës ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës.
5. Gjatë kryerjes së pushimeve vjetore, punonjësi trajtohet financiarisht në të njëjtën masë me pagën që ai merr kur është në punë/shërbim.

Neni 6

Kompensimi financiar për pushimet vjetore të pakryera

Në rastet kur punonjësi i policisë nuk e ka kryer pushimin vjetor të paguar, kompensimi financiar llogaritet mbi bazën e pagës mujore referuese, duke përfshirë elementet e mëposhtme të përhershme të pagës:

- a) paga për gradë;
- b) shtesa për funksion (për punonjësit e rolit zbatues);
- c) shtesa për natyrë të veçantë pune;
- ç) shtesa për vjetërsi në shërbim;
- d) shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin.

Neni 7

Kompensimi i pushimeve vjetore pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës

1. Punonjësi, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë së Shtetit, trajtohet menjëherë financiarisht për ditët e pushimit vjetor të pakryera, të llogaritura në raport me kohëzgjatjen e tij të punës brenda vitit kalendarik.
2. Kur punonjësi nuk ka kryer një vit të plotë kalendarik pune, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës së kryer brenda vitit kalendarik.
3. Në çdo rast, pushimi vjetor jepet me urdhër të titullarit në nivel komisariati, drejtorie apo strukture të veçantë, në bazë të planifikimit vjetor.

KREU III PUSHIME TË TJERA TË PAGUESHME

Neni 8

Rastet e pushimeve të tjera të pagueshme për punonjësit e policisë

Punonjësit të policisë i jepet leje e pagueshme për rastet, si më poshtë vijon:

- a) Martesa e tij, 5 (pesë) ditë;
- b) Lindja e fëmijës (baballarët), 3 (tri) ditë;
- c) Vdekja e bashkëshortit/bashkëjetuesit, e paraardhësve ose e pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij, 5 (pesë) ditë.

KREU IV LEJE PA TË DREJTË PAGE DERI NË 2 (DY) MUAJ

Neni 9

Procedura e miratimit të lejes pa të drejtë page deri në 2 (dy) muaj

1. Punonjësit e policisë gëzojnë të drejtën e lejes, pa të drejtë page, për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj, për arsye personale, jo më shumë se 1 (një) herë brenda një viti.
2. Miratimi i lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj jepet nga drejtuesi i strukturës qendrore, vendore apo të veçantë.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit gëzojnë të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj. Në këtë rast, miratimi i lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj bëhet nga ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

Neni 10

Kushtet për lejen pa të drejtë page

1. Periudha e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj nuk llogaritet në vjetërsi pune e shërbimi dhe as për efekt të ecurisë në karrierë.
2. Kërkesa për leje pa të drejtë page, deri në 2 (dy) muaj, dorëzohet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara fillimit të lejes.

Neni 11
Rikthimi në detyrë

Pas përfundimit të lejes pa të drejtë page, për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj, punonjësi i Policisë kthehet në të njëjtën detyrë.

KREU V
LEJE PA TË DREJTË PAGE DERI NË 6 (GJASHTË) MUAJ

Neni 12
Procedura e miratimit të lejes pa të drejtë page deri në 6 (gjashtë) muaj

1. Punonjësit e policisë gëzojnë të drejtën e lejes pa të drejtë page, për një periudhë afatgjatë deri në 6 (gjashtë) muaj, vetëm për studime, kualifikime (brenda ose jashtë shtetit) ose arsye personale të argumentuara.
2. Kërkesa për përfitimin e saj dorëzohet të paktën 1 (një) muaj para dhe miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 13
Përgjashtime

1. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk përfitojnë leje pa të drejtë page deri në 6 (gjashtë) muaj.
2. Periudha e lejes pa të drejtë page, për një periudhë afatgjatë deri në 6 (gjashtë) muaj, nuk llogaritet në vjetërsi pune e shërbimi dhe as për efekt të ecurisë në karrierë.

KREU VI
KUJDESI PËR PUNONJËSET E POLICISË SHSTATZËNA

Neni 14
Rregullat për punonjëset e policisë gjatë shtatzënisë

1. Punonjësja e policisë nuk mban uniformë policore në muajt e dukshëm të shtatzënisë.
2. Punonjësja e policisë, gjatë shtatzënisë, në pamundësi të kryerjes së detyrave funksionale në terren, mund të caktohet në detyra të tjera përveç atyre në terren.
3. Punonjësja e policisë paraqet në strukturën e burimeve njerëzore dokumentacionin ligjor, që vërteton statusin, si më poshtë vijon:

- a) Ekzaminim mjekësor, që vërteton shtatzëninë, të firmosur edhe nga drejtuesi i strukturës shëndetësore;
- b) Certifikatë familjare, në rastet kur është kryefamiljare e vetme.

Neni 15

Punët e rënda ose të rrezikshme për punonjëset e policisë shtatzëna ose me fëmijë në gji

Në Policinë e Shtetit konsiderohen punë të rënda ose të rrezikshme, për punonjëset e policisë shtatzëna apo me fëmijë, që ende nuk ka arritur moshën 1 (një) vjeç, si dhe punonjëset e policisë me fëmijë në gji:

- a) Puna në turnin e natës në të gjitha objektet;
- b) Truprojë apo truprojë-shofer në strukturat, që ofrojnë shërbim për sigurinë fizike të personaliteteve;
- c) Automekanik;
- ç) Operator, specialist i pajisjeve nën rrezatim (skaner, urë detektorët, bllokues i valëve telefonike, pajisje antidron);
- d) Magazinier i lëndëve kimike;
- dh) Instruktor në poligonin e qitjeve;
- e) Specialist në strukturat e ruajtjes nga incidentet me lëndë eksplozive dhe kimike;
- ë) Shërbimi i sigurimit të brendshëm i të arrestuarve/ndaluarve në ambientet e dhomave të sigurisë.

Neni 16

Transferimi i punonjëseve shtatzëna

Struktura e burimeve njerëzore i propozon drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit transferimin e punonjëseve, që përfshihen në nenin 14 të këtij kreu, në funksione të përshtatshme me statusin e tyre.

Neni 17

Rikthimi në punë pas lejes së lindjes

Pas përfundimit të lejes së lindjes ose ndërprerjes së saj, punonjësja ka të drejtë të kthehet në të njëjtin vend pune. Në rast të ndërprerjes së lejes së lindjes, punonjësja duhet të njoftojë 1 (një) muaj përpara drejtuesin e njësisë shpenzuese dhe strukturën e burimeve njerëzore.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Dispozita përfundimtare

1. Pushimet vjetore, lejet e pagueshme, lejet pa të drejtë page deri në 2 (dy) muaj, lejet pa të drejtë page deri në 6 (gjashtë) muaj, si dhe koha e kryerjes së tyre shënohen në dosjen e personelit të punonjësit me gradë policore.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi nr.101, datë 15.2.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për kohën e punës dhe të pushimit në Policinë e Shtetit", të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 19
Hyrja në fuqi


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare", me përjashtim të nenit 6, i cili hyn në fuqi nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI


BELINDA BALLUKU

MINISTRI I BRENDSHËM

ERVIN HOXHA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

JULIAN HODAJ


NR.PROT. 1909/1
DATE 17.4.2025

MINISTRISË SË BRENDASHME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË
SHTETIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Në mungesë dhe me porosi

